



REPUBLIKA E SHqipëRIË
MINISTRIA E FINANCAVE
DHE EKONOMISË

Planifikimi i Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor 2022-24

Roli, Përgjegjësitë & Proçesi



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

State Secretariat for Economic Affairs SECO

FINANCAT LOKALE | Strengthening
LOCAL FINANCES | Local
Government
PFM

Menaxhimi Financiar në nivel vendor

- Lidhja e planeve strategjike me programin buxhetor afatmesëm;
- Hartimi i projektbuxhetit afatmesëm si një detyrim ligjor dhe me një kalendar të përcaktuar;
- Rritja e rolit monitorues të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë në lidhje më programimin buxhetor afatmesëm;
- Standartizimi i programeve, procedurave, produkteve dhe treguesve të performancës;
- Lidhja e PBA me PPV – me anë të treguesve të performancës;
- Buxhetimi mbi bazën e programeve të standartizuara duke rregulluar në këtë mënyrë organizimin e shpenzimeve sipas funksioneve;
- Buxhetimi me programe ka lehtësuar përgatitjen e një sistemi të raportimit më të mirë në zbatimin e buxhetit, ka përmirësuar cilësinë e menaxhimit financiar në sektorë të caktuar, vendimarrje më e lehtë;

Objektivat e PBA

- **Stabiliteti dhe disiplina fiskale**
 - Mbështetje për rritjen dhe stabilitetin ekonomik
- **Alokim strategjik i burimeve financiare**
 - Lidhja e buxheteve me politikat dhe objektivat qeverisëse
- **Efektivitet, Eficence, Ekonomi**
 - Sigurimi i perfitimit maksimal për çdo qindarkë të shpenzuar

PBA dhe Qeverisja e Mirë

- **Përgjegjshmëri** - aftësia për të kërkuar llogaridhënie nga zyrtarët publikë për veprimet e tyre;
- **Transparenca** - aksesimi në informacion në një kohë të shkurtër dhe kosto minimale;
- **Parashikueshmëria** - ligjet dhe rregulloret janë të qarta, të njohura paraprakisht, të zbatuara në mënyrë uniforme dhe efektive;
- **Pjesëmarrja** - për të gjeneruar konsensus dhe për të siguruar një kontroll mbi veprimin e qeverisë;

Programi buxhetor afatmesëm

Faza e parë e quajtur strategjike, në të cilën merren vendimet më të rëndësishme në nivel strategjik dhe buxhetor.

- Këto vendime përkthehen në tavane të qëndrueshme dhe të pandryshueshme të shpenzimeve të cilat duhet të respektohen gjatë fazës teknike.
- Të gjitha vendimet kryesore strategjike/prioritare për financimin e politikave të reja merren gjatë fazës strategjike, duke përfshirë edhe vendimet për investime të reja publike

Programi buxhetor afatmesëm

Faza e dytë e rishikuar e programit buxhetor afatmesëm quhet faza teknike e përgatitjes së buxhetit vjetor.

- *Objektivi i fazës së dytë është përpunimi i detajeve teknike të buxhetit brenda tavaneve të qëndrueshme të shpenzimeve të vendosura gjatë fazës strategjike.*
- *Objektivi kryesor i kësaj faze është të sigurojë që vendimet e marra gjatë fazës strategjike të zbatohen.*



Cikli i MFP



Kuadri Institucional i PBA-së

■ Ligjet dhe udhëzimet

-Ligji nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;

Ligji nr.68, datë 27.04.2017, “Per financate e veteqeverisjes vendore”

-Udhëzimi nr. 23, datë 30.07.2018 “Për procedurat standarte të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të njvq-ve”;

■ Proçeset

- Hartimi dhe Rishikimi i Politikës (Misioni, Qëllime, Objektiva)
- Planifikimi i shpenzimeve të programit (produktet, aktivitetet)
- Planifikimi i investimeve sipas programeve
- Menaxhimi i burimeve (inputet dhe kostot e tyre)

■ Aktorët

- Këshilli NJVQV, GMS, EMP

Grupi për Menaxhimin Strategjik

- Grupi për Menaxhimin Strategjik:
 - Krijohet me urdhër të Kryetarit të NJVQV.
 - Përditësohet në fillim të procesit të përgatitjes së PBA.
- Bazohet në:
 - Ligji Nr. 10296/2010, datë 08/07/2010 për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, Neni 8/b, dhe neni 27
 - Udhëzimi Nr. 23, datë 30/07/2018 për Proçedurat Standarte të Përgatitjes së PBA në NJVQV

Grupi për Menaxhimin Strategjik

- **Përbërja** e Grupit për Menaxhimin Strategjik:
 - **Kryetar** i GMS është Kryetari i NJVQV.
 - **Koordinator** i GMS - Sekretari i Përgjithshëm / Zëvendëskryetari i NJVQ-së.
 - **Sekretar** i GMS është nëpunësi zbatues i NJVQV.
 - **Anëtarë** të GMS janë:
 - Zëvendëskryetarët e NJVQV
 - Drejtuesit e Ekipeve të Menaxhimit të Programeve buxhetore të NJVQV.
 - *Këta DEMP mund të jenë njëkohësisht edhe drejtues të njësive shpenzuese të varësisë apo drejtues të lartë të strukturave menaxheriale të bashkisë.*
 - Kreu i auditimit të brendshëm.

Ekipi për Menaxhimin e Programit

- **Ekipi i Menaxhimit të Programit (EMP)** menaxhon nje Program Buxhetor te vecante
 - GMS duhet të miratojë një EMP për çdo program të NJVQV.
- **Drejtues i EMP (DEMP)** – drejtues i nivelit të lartë në NJVQV.
 - *Mund të jetë njëkohësisht drejtor drejtorie apo njësie varësie.*
- **Anëtarë të EMP** – ekspertë të fushës së programit; përgjegjës për menaxhimin e projekteve/produkteve/aktiviteteve të programit.

Rolet & Përgjegjësitë: Kordinatori i GMS (Zëvendëskryetari/SP)

- Koordinator i GMS ka përgjegjësi të plotë për koordinimin e procesit të PBA në NJVQV. Më specifikisht:
 - *Propozimin e një kalendari të brendshëm tek GMS.*
 - *Propozimin në GMS të strukturës së programeve buxhetore dhe EMP;*
 - *Shpërndarjen për çdo EMP të udhëzimeve të brendshme të firmosura nga Kryetari i NJVQV;*
 - *Shpërndarjen për çdo EMP të Udhëzimit për Përgatitjen e PBA, së bashku me Anekset përkatëse.*

Rolet & Përgjegjësitë: Kordinatori i GMS (Zëvendëskryetari/SP)

- *Propozimin në GMS të ndarjes së Tavaneve Përgatitore të PBA, sipas programeve të NJVQV;*
- *Përcjelljen për nënshkrim tek Kryetari i NJVQV të të gjithë dokumentacionit të PBA-së;*
- *Monitorimin e respektimit të afateve të përcaktuara në kalendarin e procesit;*
- *Raportimin tek GMS dhe Kryetari i NJVQV të të gjitha shkeljeve të evidentuara lidhur me ecurinë e procesit të PBA-së brenda NJVQV.*

Rolet & Përgjegjësitë: Drejtuesi i EMP

- *Propozimin e anëtarëve të tjerë të EMP-së*
- *Menaxhimin e procesit të zbatimit të procedurave të PBA që lidhen me programin;*
- *Hartimin e një kalendari të brendshëm për EMP;*
- *Organizimin e mbledhjeve të EMP-së në etapa të ndryshme të procesit;*
- *Arritjen e marrëveshjeve dhe konsensusit brenda EMP, për të gjitha etapat e procedurave;*

Rolet & Përgjegjësitë: Drejtuesi i EMP

- *Miratimin e hedhjes në formatet e kërkuara të dhënave lidhur me programin përkatës;*
- *Firmosjen e Raporteve të Udhëzimit;*
- *Koordinimin e punës së EMP-së përkatëse me Sekretarin e GMS (Drejtorin Ekonomik/Financës) dhe/ose EMP-të e tjera të NJVQV, atëherë kur lind nevoja.*

Rolet & Përgjegjësitë: Sekretari i GMS (nëpunësi zbatues)

- **Mbështet** Koordinatorin e GMS gjatë procesit të përgatitjes së kërkesave buxhetore nëpërmjet:
 - Këshillon Koordinatorin e GMS për përgatitjen e draftit të alokimit të Tavanit Total të NJVQV sipas programeve buxhetore.
 - Orientimit të drejtuesve të programeve të njësisë, për sa i përket procesit të kostimit të aktiviteteve të programit;
 - Mbështetjen e Koordinatorit të GMS në hartimin e informacionit përmbledhës të kërkesave buxhetore të njësisë së vetëqeverisjes vendore për t'u prezantuar në GMS;
 - Organizimit të punës me vartësit e tij funksionalë për dokumentimin e procesit të diskutimeve në mbledhjet e Grupit të Menaxhimit Strategjik.

Rolet & Përgjegjësitë: Sekretari i GMS (nëpunësi zbatues)

Kujdes!

- Sekretari i GMS (nëpunësi zbatues) ka **një rol mbështetës** në procesin e përgatitjes së PBA.
- Ai nuk është më zyrtari i vetëm përgjegjës për përgatitjen e PBA dhe Buxhetit.
- Në frymën e Ligjit FV dhe udhëzimeve të reja kjo përgjegjësi tashmë ndahet midis të gjithë anëtarëve të GMS.

Vendimarrjet e GMS dhe EMP

- Menaxhimi i proçesit të përgatitjes së PBA bazohet në:
- 6 vendimarrje të GMS
- 5 vendimarrje të EMP
- 1 apo më shumë mbledhje/takime për çdo vendimarrje.



VENDIM-MARRJE TË GMS NË PROÇESIN E PËRGATITJES SË PBA-SË

Vendimmarrje 1 e GMS: Misioni & Organizimi

- Miraton:
 - Misionin e NJVQV
 - DEMP dhe EMP
 - Kalendarin e detajuar
- Shpërndan dhe shpjegon tavanet e përgatitjes së PBA-së.
- Shpërndan udhëzimin e përgatitjes së PBA Vendor 2022-24

20/03

Vendimmarrje 2 e GMS: Deklarata e Politikës së Programit

- Miraton Politikën e Programit:
 - Qëllimet
 - Objektivat, dhe
 - Treguesit Performancës

16/04

Vendimmarrje 3 e GMS: Pema e Programit

- Miraton pemën e programit për çdo program dhe për 3 vitet e ardhshme.
- Inicion planifikimin e shpenzimeve.

23/04

Vendimmarrje 4 e GMS: Shqyrtimi i Planeve të Shpenzimeve

- Shqyrton planet e shpenzimeve dhe efektet e tyre
- Udhëzon DEMP të rishikojnë planet e shpenzimeve.
- Udhëzon Koordinatorin e GMS për përgatitjen e projekt-dokumentit të PBA.

07/05

Vendimmarrje 5 e GMS: Shqyrtimi i Projekt Dokumentit të PBA

- Miraton sasitë e produkteve e planet e shpenzimeve.
- Shqyrton dhe udhëzon për ndonjë rishikim në projekt-dokumentin e PBA.

17/05

Vendimmarrje 6 e GMS: Përgatit Kërkesat Buxhetore të PBA

- Miraton versionin përfundimtar të raporteve dhe project dokumentit PBA për t'u dorëzuar në MFE.
- Përgatit dokumentat për t'u nënshkruar nga Kryetari i GMS.

28/05

Vendimmarrje 1 e EMP: Deklarata e Politikës së Programit

- Rishikon dhe miraton:
 - Politikën e programit
 - Qëllimet
 - Objektivat
 - TKP.
- Dorëzoon DPP tek Koordinatorin e GMS.

10/04

Vendimmarrje 2 e EMP: Pema e Programit

- Identifikon:
 - Projektet
 - Produktet
 - Aktivitetet
- Përgatit Pemën e Programit dhe e dorëzoon tek Koordinatorin e GMS.

21/04

Vendimmarrje 3 e EMP: Përgatit Planin e Shpenzimeve

- Diskuton dhe miraton specifikimet për:
 - Produktet
 - Aktivitetet
 - Sasitë e produkteve.
 - Shpenzimet për aktivitetet
- Mbyll mangësitë në financim
- Dorëzoon planin e shpenzimeve tek Koordinatorin e GMS

30/04

Vendimmarrje 4 e EMP: Rishqyrton Planin e Shpenzimeve

- Rishqyrton dhe miraton planin e shpenzimeve dhe DPP nëse nevojitet
- Dorëzoon dokumentet e mësipërme tek Koordinatorin e GMS.

13/05

Vendimmarrje 5 e EMP: Finalizon kërkesat buxhetore

- Përgatit versionin përfundimtar të DPP dhe raporteve të planeve të shpenzimeve.
- Dorëzoon versionin përfundimtar të raporteve tek Koordinatorin e GMS.

24/05

VENDIM-MARRJE TË EMP NË PROÇESIN E PËRGATITJES SË PBA-SË



- Faleminderit
- Pyetje & Pergjigje